

**AKT THEMELIMI**  
**I SHOQËRISË “HAMSA” Sh.p.k.**

Sot, me datë 14/09/2020

**Z.Mario Gjoka**, shtetas Shqiptar, lindur më 29/03/1983, në Lezhe, Shqiperi, mbajtëse i kartes ID me nr. 031284864, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar;

**Zj.Liljanë Gjoka**, shtetase Shqiptare, lindur më 09/01/1962 në Hot I Ri Shkoder, Shqiperi, mbajtëse e kartes ID me nr. 031590877, madhore e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar;

Në përputhje me ligjin 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtaret dhe Shoqërite Tregtare" (i ndryshuar) dhe ligjit nr. 9723, dt. 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", kam vendosur të themeloj një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të emërtuar **“HAMSA”**. (më poshtë referuar si "Shoqëria").

**NENI 1**

**EMËRTIMI**

Emri i Shoqërisë është **“HAMSA” Sh.p.k.**

**NENI 2**

**SELIA**

Selia zyrtare e Shoqërisë ndodhet në adresën: Mali Shengjin, Zona Kadastrale 2569 ,Nr Pasurie 816/6, Lezhe.

Asambleja e ortakëve mund të themelojë filiale, seli dytësore ose njësi të tjera operative si dhe të transferojë selinë e shoqërisë në një adresë apo qytet tjetër.

**NENI 3**

**KOHËZGJATJA**

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një afat të pacaktuar, përveç zgjatjes ose prishjes së mëparshme të saj sipas vendimit të Asmablesë së Ortakëve.

**NENI 4**

**OBJEKTI**

Shoqëria ka si objekt të veprimtarisë së saj:

*-Zbatim i punimeve të ndertimit në banesa civile dhe industriale, turistike e bujqesore dhe kompletimin e tyre me instalimin e nevojshëm hidrosanitar, elektrik, punime të dheut dhe tarracimeve. Ndertim të rrugeve, asfaltimeve dhe veprave të artit. Prodhim e tregetim me shumicë e pakice të të gjitha llojeve të materialeve të ndertimit, inerte etj. Import eksport të mallrave industriale, ushqimore, lende të para etj. Pjesëmarrja e shoqërisë në tendera, koncesione apo në çdo procedurë tjetër konkurrimi kombëtar apo ndërkombëtar, vetëm apo në bashkëpunim me subjekte të tjera pa kufizim përsa i përket objektit sa me sipër. Shoqëria mund të kryejë aktivitete të tjera të lidhura ose plotësuese me ato të parat dhe çdo aktivitet tjetër të nevojshëm ose të dobishëm për qëllimin e shoqërisë.,*

*-Investitor në ndertim, etj;*

*-Sherbim Hotelerie, Akomodimi, Bar Restorant, Katering. Sherbim Take away, delivery.*

Shoqëria mund të kryejë gjithashtu të gjitha operacionet tregtare, mbi pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, që do të vlerësohen të nevojshme apo të dobishme për realizimin e objektit të shoqërisë si dhe të blejë pjesëmarrje në kapitalin themeltar të shoqërive të tjera që kanë objekt të ngjashëm apo të përafërt me të vetin. Gjithashtu, brenda kufijve të përcaktuar nga ligji mund të lëshojë garanci, letra dëmshpërblimi dhe çdo garanci tjetër reale.

Shoqëria në ushtrimin e aktivitetit të saj, do të marrë të gjitha autorizimet e lejet e nevojshme pranë institucioneve publike shqiptare, dhe do të mbështetet në rregullat dhe normat në fuqi në lidhje me ushtrimin e veprimtarisë së saj të rregullt ekonomike.

## **NENI 5**

### **KAPITALI THEMELTAR**

Kapitali themeltar është i përbërë nga kontributet në të holla të ortakëve themelues në vlerën 15.000.000 leke dhe është i ndarë në 2 kuota.

Kapitali themeltar ndahet si më poshtë:

- **Znj. Liljanë Gjoka**, zoteron 1 kuotë, me 90% të kapitalit themeltar, me 1 (një) pjesë me vlerë 13.500.000 Leke .
- **Z. Mario Gjoka**, zoteron 1 kuotë, me 10% të kapitalit themeltar, me 1 (një) pjesë me vlerë 1.500.000 Leke .

Kapitali themeltar mund të zmadhohet nëpërmjet kontributeve të reja në para ose në natyrë, sipas vendimeve të asamblesë së ortakëve të marra më shumicën e parashikuara për ndryshimin e këtij statuti.

## NENI 6

### ORGANET E SHOQËRISË

Organet e shoqërisë përbëhen nga Asambleja e ortakëve dhe Organi administrativ.

- Asambleja e ortakëve është organi vendimmarrës i shoqërisë e cila vepron në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.
- Organi i vetëm administrativ i shoqërisë është Administratori i vetëm i shoqërisë është **Z. Mario Gjoka**, shtetas Shqiptar, lindur më 29/03/1983, në Lezhe, Shqiperi, mbajtëse i kartes ID me nr. 031284864, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, i cili zgjidhet për një periudhë prej 5 (pesë) vjet, me të drejtë rizgjedhjeje.

## NENI 7

### LEGJISLACIONI I APLIKUESHËM

Aktiviteti i shoqërisë do të rregullohet nga dispozitat e statutit të shoqërisë, si dhe nga të gjitha dispozitat ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

## NENI 8

### DISPOZITA FINALE

Ky Akt Themelimi hartohet në 4 (katër) kopje origjinale në gjuhën shqipe.

Permbajtja e Aktit të Themelimit u lexua dhe nënshkrua nga Ortakët themelues të shoqërisë duke autorizuar \_\_\_\_\_, shtetas Shqiptar, lindur më \_\_\_\_\_, në \_\_\_\_\_ Shqiperi, mbajtëse i kartes ID me nr. \_\_\_\_\_, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, për të kryer të gjitha veprimet e nevojshme për regjistrimin e shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) në Tiranë.

### ORTAKËT THEMELUES

Liljanë Gjoka



Mario Gjoka

